

HANDIKOS

SHOQATA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR - HANDIKOS FERIZAJ
ASSOCIATION OF PERSONS WITH DISABILITY - HANDIKOS FERIZAJ

2025

RAPORTI VJETOR



FERIZAJ 2025

PËRMBAJTJA

◆ Parathënie.....	1
◆ Përmbledhje ekzekutive.....	3
◆ HYRJE.....	4
◆ Projektet e implementuara përgjatë 2025.....	8
◆ Shërbimet e ofruara përgjatë 2025.....	11
○ Shërbimet ditore për fëmijë.....	12
○ Shërbimet ditore për të rritur.....	15
○ Shërbimet e pajisjeve ndihmëse	18
○ Shërbimet juridike.....	20
○ Shërbime të tjera	21
◆ Intervenimet avokuese dhe lobuese.....	28
◆ Publikime.....	30

PARATHËNIE

Handikos Ferizaj është një organizatë me mision të qartë dhe të palëkundur për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Që nga themelimi, organizata ka qenë një zë i fuqishëm në komunitet, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror, në ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta dhe në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më të barabartë.

Roli i Handikos Ferizaj në komunitet shtrihet përtej ofrimit të shërbimeve sociale. Organizata ka qenë dhe mbetet një urë lidhëse ndërmjet familjeve, institucioneve publike dhe partnerëve vendorë e ndërkombëtarë, duke krijuar hapësira për bashkëpunim, avokim dhe ndikim pozitiv në politikat lokale. Përmes programeve rehabilituese, këshillimit profesional, aktiviteteve edukative dhe përfshirjes sociale, Handikos Ferizaj ka kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara.

Një nga shtyllat kryesore të punës së organizatës është fuqizimi i familjes si mbështetje primare për personat me aftësi të kufizuara. Duke ofruar këshillim, orientim dhe mbështetje psiko-sociale, Handikos Ferizaj synon të ndërtojë një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe motivues për zhvillimin maksimal të potencialit të çdo individi.

Në të njëjtën kohë, organizata ka luajtur rol aktiv në promovimin e qasjes fizike në institucione publike, në arsim gjithëpërfshirës dhe në pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike. Përmes nismave të ndryshme, është punuar që zëri i tyre të dëgjohej dhe të respektohet në proceset vendimmarrëse.

Synimet për të ardhmen e Handikos Ferizaj janë të qarta dhe ambicioze. Organizata synon zgjerimin e shërbimeve ekzistuese, ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, si dhe krijimin e programeve të reja inovative që adresojnë nevojat reale të përfituesve. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet avancimit të politikave lokale për përfshirje sociale, rritjes së bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe komunale, si dhe sigurimit të qëndrueshmërisë financiare përmes partneriteteve strategjike.

Handikos Ferizaj mbetet e përkushtuar ndaj vizionit për një shoqëri ku çdo person, pa dallim, ka të drejta të barabarta, qasje të plotë dhe mundësi për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit. Me përkushtim, transparencë dhe profesionalizëm, organizata do të vazhdojë të jetë një shtyllë e rëndësishme e përfshirjes dhe solidaritetit në shoqërinë tonë.



Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesë e integruar e shoqërisë në tërësi dhe atyre duhet t'u ofrohet mundësia drejt pavarësisimit individual, ku përmes përvojës, talenteve dhe kapaciteteve të tyre të kontribuojnë në zhvillimin e shtetit tonë.



Enver Kosumi Drejtor Ekzekutiv

RRETH HANDIKOS FERIZAJ

Shoqata e personave me aftësi të kufizuar – Handikos Ferizaj veprimtarinë e saj e ka filluar që nga viti 1995 përmes Programit të Rehabilitimit Bazuar në Komunitet. Rehabilitimi i Bazuar në Komunitet (RBK) është strategji në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të komunitetit, për rehabilitim, barazim të mundësive dhe përfshirje sociale të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuar dhe zhvillohet përmes përpjekjeve të kombinuara të vetë personave me aftësi të kufizuar, familjeve të tyre, komunitetit dhe shërbimeve përkatëse të shëndetësisë, arsimit, shërbimeve profesionale dhe sociale”.

HISTORIKU

Handikos Ferizaj ka qenë pjesë e HANDIKOS-it e cila është themeluar në vitin 1983 dhe fillimisht ka qenë e emëruar si Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve e Kosovës. Gjatë fazës emergjente të pas-luftës, HANDIKOS-i është shndërruar në ofrues të shërbimeve duke tentuar të mbulojë disa nga nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Me këtë rast, HANDIKOS ka ofruar materiale ortopedike, sanitare dhe materiale për parandalimin e plagëve dekubitare. HANDIKOS ka vepruar në tërë Kosovën dhe ka ofruar shërbimet e njëjta për të gjitha komunitetet pa dallim etnie, feje dhe race. Dega në Ferizaj, së bashku me të gjitha degët e tjera të HANDIKOS-it, që nga viti 2015 është pavarësuar në aspektin administrativ e programor nga qendra në Prishtinë dhe tani është e regjistruar si OJQ në vete. Kjo shkëputje është bërë me planifikim paraprak me qëllim të forcimit organizativ të qendrave gjithandej Kosovës, rritjes së qëndrueshmërisë së shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet dhe përmbushjes së nevojave të përfituesve në mënyrë më efikase.

VIZIONI:

Shoqëri gjithëpërfshirëse me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara.

MISIONI:

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare që punon në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes avokimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- Përmirësimi i politikave publike dhe rritja e zbatimit të ligjeve e strategjive relevante për personat me aftësi të kufizuara.
- Rritja e cilësisë dhe njohërit zgjerimi i shërbimeve të ofruara me bazë në komunitet.
- Rritja e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës.



Enver Kosumi
Drejtor Ekzekutiv



Zana Shabani
Menaxhere e Programit



Trëndëlinë Ymeri
Koordinatorë e Projekteve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor 2025 paraqet një pasqyrë të përmblendhur të punës, të arriturave dhe ndikimit të Handikos Ferizaj gjatë vitit 2025, në kuadër të programeve dhe projekteve të implementuara me mbështetje të donatorëve vendorë dhe ndërkombëtarë.

Të dhënat e paraqitura bazohen në rezultatet konkrete të shërbimeve dhe aktiviteteve të ofruara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka vazhduar me përkushtim misionin e saj për avancimin dhe përmirësimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, përmes ofrimit të shërbimeve profesionale, mbështetjes sociale dhe avokimit për të drejtat e tyre njerëzore.

Në kuadër të shërbimeve direkte, janë përfshirë gjithsej 104 fëmijë me aftësi të kufizuara, prej tyre 71 djem dhe 33 vajza, të cilëve u janë ofruar 4,540 shërbime përgjatë vitit. Këto shërbime kanë kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin, rehabilitimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve përfitues dhe familjeve të tyre.

Njëkohësisht, Handikos Ferizaj ka ofruar mbështetje përmes pajisjeve ndihmëse për 330 qytetarët me aftësi të kufizuara, konkretisht: 27 persona të pajisur me shtretër ortopedikë; 38 persona me karroca manuale; 2 persona me karroca elektrik; 24 persona me tualet-karroca; 55 persona me shëtitore (walker); 34 persona me kukza (paterica); 150 familje të mbështetura çdo muaj me materiale për inkontinencë

Në fushën e mbrojtjes së të drejtave njerëzore, gjatë vitit 2025 janë ofruar 55 këshilla ligjore për persona me aftësi të kufizuara, nga të cilat 11 raste kanë qenë ankesa, duke kontribuar në adresimin e shkeljeve dhe përmbushjen e të drejtave të garantuara me ligj.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe i strukturuar me organizata të shoqërisë civile, organizata të personave me aftësi të kufizuara, organizata ndërkombëtare, institucione lokale dhe qendrore, si dhe me vetë komunitetin e aftësisë së kufizuar, ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e përditshëm të organizatës, në adresimin e nevojave reale dhe në përmirësimin e pozitës së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Pavarësisht mungesës së statistikave zyrtare dhe të sakta për pre valencën e aftësisë së kufizuar në nivel vendi, data baza e Handikos Ferizaj përfshin mbi 1,075 anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara, të moshave, gjinive dhe etnive të ndryshme.

Handikos Ferizaj mbetet e përkushtuar në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse, ku personat me aftësi të kufizuara gëzojnë njohje, dinjitet dhe realizim të plotë të të drejtave të tyre njerëzore.

PROJEKTET QË HANDIKOS FERIZAJ KA IMPLEMENTUAR PËRGJATË 2025

[Zhvillimi i kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara – mbështetur nga Ministria e Drejtësisë.](#)

❖ OBJEKTIVAT:

- Mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara që të zhvillojnë aftësitë e tyre, praktikojnë pavarësinë dhe të mundësohet përfshirja e tyre në shkollë dhe jetën në komunitet, përmes ofrimit të shërbimeve rehabilituese multicisiplinare me bazë në komunitet të cilësisë së lartë.
- Mbështetja e familjeve për të tejkaluar vështirësitë dhe aftësimin e tyre për të përkrahur zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor dhe për të avokuar për të drejtat e fëmijëve të tyre.
- Rritja e kapaciteteve të palëve të interesit në identifikimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, të përgjigjen/adresojnë këto nevoja dhe monitorojnë progresin si dhe përfshirjen e tyre në ngjarje dhe fushata promovuese për të drejtat e fëmijëve për të ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve publike.

[Art dhe Trashëgimi për të gjithë, Pa Barriera – mbështetur nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport](#)

❖ OBJEKTIVAT:

- Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete kulturore dhe kreative:
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi mbi trashëgiminë kulturore:
- Krijimi i mundësive për shprehjen artistike dhe promovimin e krijimtarisë:

[Piloting of family-centered Early Childhood Intervention services in five selected municipalities”, të implementuar nga HANDIKOS \(Prishtinë\) në bashkëpunim me Handikos Ferizaj dhe mbështetur nga UNICEF](#)

❖ OBJEKTIVAT:

Ofrimi i shërbimeve në fëmijërinë e hershme është një koncept që lidhet me ofrimin e mbështetjes dhe kujdesit të duhur për zhvillimin e fëmijëve nga mosha e lindjes deri në moshën e parashikuar për fillimin e shkollës. Ky proces përfshin shërbime edukative, shëndetësore, psikologjike dhe sociale që kanë për qëllim të ndihmojnë në rritjen e fëmijëve të shëndetshëm dhe të zhvilluar si individë të plot

MBËSHTETJA FINANCIARE DHE PARTNERITETET GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka vazhduar ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara falë mbështetjes së qëndrueshme nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, UNICEF si dhe Komuna e Ferizajt e cila ka mbështetur Qiranë e Objektivit, si dhe falë solidaritetit të komunitetit lokal. Përkrahje të çmuar kanë dhënë edhe bizneset vendore Autosherreti, Besa Kompani, Poliklinika Zeka, FerPrint dhe Këshilli i Bashkësisë Islame Ferizaj, ndërsa një mirënjohje e veçantë u shkon individëve z. Raif Marevci dhe z. Alush Zeqiri. Kjo mbështetje e gjerë institucionale, lokale dhe individuale ka qenë vendimtare për ruajtjen e vazhdimësisë së shërbimeve, forcimin e kapaciteteve organizative dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

SHËRBIMET PSIKOLOGJIKE PËR FËMIJËT


2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka ofruar shërbime të mbështetjes psikologjike për gjithsej 28 fëmijë me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 22 djem dhe 6 vajza. Këto shërbime janë realizuar përmes 1,045 seancave individuale, duke reflektuar përkushtimin e vazhdueshëm të organizatës për të adresuar nevojat emocionale dhe zhvillimore të fëmijëve.

Ofrimi i mbështetjes psikologjike ka pasur për qëllim forcimin e mirëqenies emocionale, zhvillimin e reziliencës dhe përmirësimin e aftësive të fëmijëve për t'u përballur me sfidat e përditshme. Përmes këtyre ndërhyrjeve, është synuar gjithashtu nxitja e zhvillimit mendor dhe rritja e përfshirjes sociale të fëmijëve në komunitet.

Shërbimet psikologjike janë të dizajnuara për të përmbushur nevojat individuale të fëmijëve dhe përfshijnë:

- Seanca këshilluese dhe mbështetje emocionale,
- Zhvillimin e aftësive sociale dhe ndërpersonale,
- Ndhimë për përballimin e stresit dhe emocioneve të vështira,
- Mbështetje në trajtimin e sfidave mendore dhe emocionale që mund të shfaqen gjatë fëmijërisë.



SHËRBIMET LOGOPEDIKE – 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka ofruar shërbime logopedike për 27 fëmijë me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 21 djem dhe 6 vajza, përmes 984 seancave individuale. Kjo mbështetje ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe shprehjes së fëmijëve. Shërbimet e logopedisë fokusohen në zhvillimin e aftësive të folurit dhe dëgjimit, duke ofruar ndërhyrje të personalizuar për trajtimin e vështirësive të ndryshme gjuhësore dhe komunikative.

Përmes kësaj mbështetje, fëmijët fitojnë vetëbesim në komunikim dhe rriten mundësitë e tyre për integrim social dhe arsimor. Qëllimi i këtyre shërbimeve është të forcojë aftësitë komunikative të fëmijëve dhe të lehtësojë përfshirjen e tyre aktive në jetën familjare, shkollore dhe komunitare.



SHËRBIMET E EDUKIMIT JOFORMAL 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka ofruar shërbime të edukimit joformal për gjithsej 25 fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët kanë përfituar nga aktivitete dhe ndërhyrje edukative jashtë sistemit formal të arsimit. Nga numri i përgjithshëm i përfituesve, 16 kanë qenë djem dhe 9 vajza, duke reflektuar përfshirje të balancuar gjinore.

Në kuadër të këtyre shërbimeve, gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 901 seanca individuale të edukimit joformal, të orientuara sipas nevojave specifike të secilit fëmijë. Përmes mbështetjes së personalizuar, këto seanca kanë synuar zhvillimin e aftësive personale, forcimin e aftësive sociale, njohëse, emocionale dhe kreative, si dhe përmirësimin e sjelljes sociale dhe rritjen e vetëbesimit.

Shërbimet janë organizuar në mënyrë të tillë që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për përfshirje dhe përfitim, duke respektuar diversitetin gjinor dhe nevojat individuale. Edukimi joformal gjatë vitit 2025 ka shërbyer si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e fëmijëve dhe përkrahjen e zhvillimit të tyre të gjithanshëm në një mjedis mbështetës dhe nxitës për të mësuar.



SHËRBIMET E FIZIOTERAPISË – 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka ofruar shërbime fizioterapisë për gjithsej 23 fëmijë me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 13 djem dhe 10 vajza. Shërbimet janë realizuar përmes 917 seancave individuale, të cilat kanë qenë të strukturuar sipas nevojave specifike të secilit fëmijë dhe të orientuara drejt përmirësimit të funksionalitetit fizik.

Ndërhyrjet fizioterapisë janë fokusuar në përmirësimin e lëvizshmërisë, forcimin e muskujve, rritjen e fleksibilitetit dhe zhvillimin e aftësive motorike bazë dhe të avancuara, të cilat janë thelbësore për funksionimin e pavarur dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në jetën e përditshme. Përmes një qasjeje të personalizuar dhe profesionale, terapistët kanë ndihmuar fëmijët të përballojnë sfidat fizike, të parandalojnë përkeqësimin e gjendjes funksionale dhe të arrijnë progres të qëndrueshëm në aftësitë e tyre motorike.

Përveç ndikimit fizik, shërbimet e fizioterapisë kanë pasur një rol të rëndësishëm edhe në aspektin psikosocial. Përmirësimi i aftësive funksionale ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e vetëbesimit, autonomisë dhe motivimit të fëmijëve, duke u mundësuar atyre përfshirje më aktive në aktivitetet shkollore, sociale dhe rekreative.



AKTIVITETET GRUPORE, SOCIALIZUESE DHE REKREATIVE PËR FËMIJË – 2025



Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka realizuar aktivitete grupore, socializuese dhe ndërgjegjësuere me pjesëmarrjen e gjithsej **97 fëmijëve, prej të cilëve 66 djem dhe 31 vajza**. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ka qenë nxitja e bashkëpunimit, zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale, rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i vlerave pozitive tek fëmijët. Pjesëmarrja aktive në këto aktivitete ka mundësuar përfshirjen e çdo fëmije në ndërveprime edukative dhe sociale, duke kontribuar në ndërtimin e një komuniteti mbështetës dhe bashkëpunues.

Gjatë vitit janë organizuar dhe zhvilluar 30 aktivitete grupore, të cilat kanë përfshirë tema ndërgjegjësuere, punë bashkëpunuese në grup dhe ushtrime praktike, të orientuara drejt zhvillimit të aftësive komunikuese, forcimit të tolerancës, respektit për diversitetin dhe ndërtimit të ndjenjës së përkatësisë sociale. Çdo aktivitet është menduar për të qenë gjithëpërfshirës dhe për të adresuar nevojat individuale të fëmijëve, duke krijuar mundësi që secili të shprehet, të marrë pjesë aktivisht dhe të ndjejë vlerësim brenda grupit.

Aktivitetet janë organizuar në mënyrë të strukturuar dhe të sigurt, duke promovuar një mjedis mbështetës që nxit socializimin, zhvillimin shëndetësor psikosocial dhe ndërveprimin pozitiv mes fëmijëve. Përmes këtyre ndërhyrjeve, fëmijët kanë mundur të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për jetën e përditshme, të forcojnë vetëbesimin dhe të përgatiten për sfida sociale dhe arsimore, duke kontribuar në rritjen e mirëqenies dhe zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Aktivitetet Socializuese dhe Rekreative për Adoleshentë dhe të Rritur – 2025

Gjatë vitit 2025, në kuadër të projektit **“Art dhe Kulturë pa Barriera për të Gjithë”**, Handikos Ferizaj ka zhvilluar aktivitete rekreative dhe socializuese që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e mirëqenies psiko-sociale dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë gjithsej 17 anëtarë, prej të cilëve 7 meshkuj dhe 10 femra.

Aktivitetet janë konceptuar dhe realizuar me synimin për të krijuar hapësira gjithëpërfshirëse, që nxisin relaksim, shprehjen kreative dhe ndërveprimin social. Përmes pjesëmarrjes aktive, individët kanë pasur mundësi të zhvillojnë aftësi sociale, të forcojnë vetëbesimin dhe të ndjehen pjesë e komunitetit.

Gjithashtu, këto aktivitete kanë kontribuar në promovimin e barazisë dhe qasjes së barabartë në aktivitetet kulturore dhe rekreative, duke siguruar që çdo pjesëmarrës të përfitojë në mënyrë të barabartë dhe të ndjehet i vlerësuar. Përmes ndërhyrjeve të tilla, projektet e Handikos Ferizaj kanë mundur rritjen e përfshirjes sociale, zhvillimin personal dhe krijimin e një mjedisi mbështetës dhe motivues për adoleshentët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.



SHËRBIMET E OFRUARA NGA UNICEF – PROGRAMI PËR NDËRHYRJEN NË FËMIJËRINË E HERSHME


Në kuadër të projektit të UNICEF-it, Handikos Ferizaj ka ofruar shërbime për fëmijët 0–6 vjeç, duke u fokusuar në identifikimin e hershëm dhe mbështetjen gjithëpërfshirëse të zhvillimit të tyre. Përmes bashkëpunimit me institucione arsimore, shëndetësore dhe sociale, janë identifikuar fëmijë dhe familje me aftësi të kufizuara, të cilëve u janë ofruar shërbime në shtëpi, kopshte dhe shkolla.

Gjatë këtij projekti janë vlerësuar gjithsej 90 familje, nga të cilat 66 fëmijë dhe familje kanë përmbushur kriteret e pranueshmerisë dhe kanë përfituar shërbime.

Konkretisht, shërbimet janë ofruar për 37 fëmijë në kopshte, 20 në shtëpi dhe 7 në shkolla, duke realizuar gjithsej 1,435 ndërhyrje.

Shërbimet e ofruara përfshijnë logopedi, psikologji, fizioterapi dhe edukim joformal, të përshtatura në mënyrë individuale sipas nevojave të çdo fëmije.

Përveç ndërhyrjeve direkte, janë organizuar gjithashtu sesione informuese dhe ndërgjegjësuere në shkolla, përfshirë SHFMU “Vezir Jashari”, “Ahmet Hoxha” dhe “Gjon Serreçi”; në kopshtet Ninulla Academy, Engjujt, Ardhmëria Jonë dhe WeKids; si dhe në institucione shëndetësore e sociale si QKMF dhe Qendra për Punë Sociale. Këto aktivitete kanë synuar të rrisin ndërgjegjësimin e komunitetit për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të përforcojnë mbështetjen gjithëpërfshirëse në zhvillimin e hershëm të tyre.



SESIONE DHE LIGJËRATA INFORMUESE – 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka organizuar sesione dhe ligjërata informuese në shkollat fillore të mesme të ulëta, shkollat e mesme të larta dhe shkollat profesionale, me qëllim rritjen e vetëdijes dhe informimin e nxënësve, mësimitdhënësve dhe stafit arsimor. Në këto aktivitete janë trajtuar tema të rëndësishme, si parandalimi i bullizmit, ndërhyrja në fëmijërinë e hershme, si dhe rëndësia e krijimit të një mjedisi shoqëror miqësor, të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.

Ligjëratat kanë nxitur diskutime të hapura dhe ndërveprim aktiv, duke theksuar rolin e shkollës, familjes dhe komunitetit në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe në promovimin e barazisë, respektit dhe pranimit të diversitetit. Këto sesione dhe ligjërata kanë kontribuar në forcimin e kulturës së bashkëjetesës dhe përfshirjes sociale brenda institucioneve arsimore, duke u shndërruar në një mjet efektiv për ndërtimin e mjediseve edukative më të sigurta dhe më mbështetëse për çdo fëmijë dhe të ri.



AKTIVITETET KREATIVE DHE REKREATIVE 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka zhvilluar një sërë aktivitete kreative dhe rekreative për fëmijët dhe prindërit, me qëllim socializimin, relaksim dhe forcimin e lidhjeve familjare. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë organizuar vizita në destinacione të ndryshme, përfshirë Parkun e Lirisë, Qendrën në Kripë, Villa Pauna, Qendrën e Kalërimit, Park Woodside dhe Prekaz, ku fëmijët dhe familjet kanë pasur mundësi të angazhohen në aktivitete argëtuese dhe edukative.

Më 1 Qershor është organizuar një festë gjithëpërfshirëse në sheshin e qytetit, e dedikuar për të gjithë fëmijët, duke promovuar barazinë, përfshirjen dhe të drejtën e çdo fëmije për argëtim dhe pjesëmarrje aktive në komunitet.

Për më tepër, me rastin e festave kombëtare të 17 Shkurtit dhe 28 Nëntorit, janë zhvilluar vizita përkujtimore në Prekaz, si aktivitete edukative dhe përkujtimore, me qëllim kultivimin e ndjenjës së identitetit, respektit dhe vlerave kombëtare tek fëmijët dhe familjet pjesëmarrëse. Këto aktivitete kanë kontribuar në zhvillimin social, emocional dhe kulturor të fëmijëve, duke ofruar një mjedis mbështetës, nxitës dhe gjithëpërfshirës për rritjen dhe argëtimin e tyre.



AKTIVITETET INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE – 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka realizuar një sërë aktivitetesh informuese dhe ndërgjegjësuese, duke u fokusuar në promovimin e përfshirjes sociale dhe të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Më 21 Mars, me rastin e **Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down**, u organizua një aktivitet ndërgjegjësues me nxënës të shkollave, ndërsa më 2 Prill, me rastin e **Ditës Ndërkombëtare të Autizmit**, u zhvillua një aktivitet grupor. Më 20 Nëntor, për **Ditën Botërore të Fëmijëve**, u realizua një marsh sensibilizues për të drejtat në arsimim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndërsa më 1 Qershor u organizua një festë gjithëpërfshirëse në sheshin e qytetit, e dedikuar për të gjithë fëmijët.

Gjithashtu, me rastin e **3 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara**, u mbajt një aktivitet grupor me pjesëmarrjen e anëtarëve të Handikos Ferizaj dhe nxënësve të shkollave, duke theksuar rëndësinë e ndërgjegjësimit, respektit dhe përfshirjes aktive të të gjithëve në komunitet.



Shënimi i 10-vjetorit të themelimit të Handikos Ferizaj

Aktiviteti për shënimin e 10-vjetorit të themelimit të Handikos Ferizaj u realizua në një atmosferë solemne dhe emocionale, duke mbledhur përfaqësues institucionale, bashkëpunëtorë, përfitues të shërbimeve dhe miq të organizatës. Ky event shërbeu si një moment reflektimi mbi rrugëtimin një dekade, duke theksuar arritjet kryesore në ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara dhe kontributin në avancimin e të drejtave dhe përfshirjes së tyre në shoqëri.



Gjatë aktivitetit, u prezantuan zhvillimet kryesore ndër vite, përfshirë zgjerimin e shërbimeve, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndikimin konkret në jetën e përfituesve dhe familjeve të tyre. Një theks i veçantë iu kushtua mirënjohjes për të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë rrugëtim – stafin, donatorët, partnerët dhe komunitetin – duke vlerësuar rolin e tyre në ndërtimin e një organizate të qëndrueshme dhe të besueshme.



Në përmbyllje, u ritheksua angazhimi i Handikos Ferizaj për të vazhduar misionin e saj me përkushtim edhe në të ardhmen, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe zgjerimin e ndikimit në komunitet. Ky përvjetor jo vetëm që shënoi një arritje të rëndësishme, por edhe forcoi vizionin për një shoqëri më gjithëpërfshirëse, ku çdo individ trajtohet me dinjitet dhe barazi.

Vlerësim institucional me Çmimin për Demokraci për Drejtorin Ekzekutiv të Handikos Ferizaj



Gjatë periudhës raportuese, Handikos Ferizaj shënoi një arritje të rëndësishme në nivel institucional dhe përfaqësues, ku z. Enver Kosumi, Drejtor Ekzekutiv i organizatës, u shpall laureat i Çmimit për Demokraci, ndarë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Ky vlerësim përbën një njohje të drejtpërdrejtë për kontributin e vazhdueshëm dhe angazhimin e tij në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si dhe në fuqizimin e parimeve demokratike dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Ky sukses reflekton jo vetëm përkushtimin individual, por edhe punën e koordinuar dhe të qëndrueshme të ekipit të Handikos Ferizaj, si dhe bashkëpunimin e ngushtë me komunitetin, partnerët dhe donatorët. Çmimi shërben si një tregues i ndikimit pozitiv të organizatës në avancimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar dhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë.

Në të njëjtën kohë, ky vlerësim përbën një motivim shtesë për organizatën që të vazhdojë me përkushtim misionin e saj, duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe duke forcuar rolin e saj në avokimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Handikos Ferizaj mbetet e angazhuar për të kontribuar në zhvillimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe me përgjegjësi qytetare.

VIZITA TË RËNDËSISHME NË QENDËR


Qendra e Handikos Ferizaj ka pritur vizita të rëndësishme institucionale që kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndërinstitucionale. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, më 3 dhjetor, qendrën e vizitoi **Znj. Vjosa Osmani**, Presidente e Republikës së Kosovës. Gjatë vizitës, ajo u takua me fëmijët përfitues, prindërit dhe stafin e organizatës, ku u diskutua për rëndësinë e përfshirjes sociale dhe mbështetjes institucionale për personat me aftësi të kufizuara, duke vlerësuar njëkohësisht punën dhe përkushtimin e qendrës.

Gjatë vitit 2025, Qendra e Handikos Ferizaj ka pritur në vizitë **Znj. Albulena Haxhiu**, Ministre e Drejtësisë, së bashku me zëvendësministrin Vigan Qorrolli. Vizita u realizua në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Handikos Ferizaj dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim diskutimin e çështjeve të rëndësishme për përmirësimin e mbështetjes institucionale dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka zhvilluar disa takime me deputetin **Elmi Reçica**, si mik i vjetër dhe përkrahës i vazhdueshëm i punës së organizatës. Këto takime kanë shërbyer për forcimin e bashkëpunimit dhe për adresimin e çështjeve që lidhen me mbështetjen dhe avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara



Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka zhvilluar takime edhe me deputetin **Valon Ramadani**, si përkrahës i rëndësishëm për ndërtimin e qendrës. Këto takime kanë kontribuar në forcimin e bashkëpunimit institucional dhe në avancimin e iniciativave për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.



Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka pritur gjithashtu në vizitë deputeten **Arbnora Salihu**, e cila ka shprehur mbështetjen e saj për punën e organizatës dhe për angazhimet në avancimin e të drejtave dhe përmirësimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara.



Gjatë vitit 2025, në kuadër të programit “Early Childhood Intervention Services”, i cili implementohet nga HANDIKOS (Prishtinë) në bashkëpunim me Handikos Ferizaj dhe me mbështetjen e UNICEF-it, Handikos Ferizaj realizoi vizitë zyrtare në qendër në kuadër të aktiviteteve monitoruese dhe koordinuese të projektit.

Në këtë vizitë morën pjesë:

Znj. Veronika Vashchenko, Shefe e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë dhe

Znj. Dafina Muçaj, Menaxhere e Programit të UNICEF-it

Gjatë vizitës u diskutua për ecurinë e zbatimit të programit, shërbimet e ofruara për fëmijët dhe familjet përfituese, si dhe për ndikimin e projektit në përmirësimin e ndërhyrjes së hershme në fëmijëri. Vizita shërbeu gjithashtu për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet HANDIKOS Ferizaj dhe UNICEF-it, si dhe për identifikimin e nevojave dhe mundësive për zhvillim të mëtejshëm të shërbimeve.



MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT – 2025

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe partnerë lokalë, me qëllim fuqizimin e shërbimeve për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara.

SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS –

Drejtorja Rajonale Ferizaj: bashkëpunim për aplikimin e masave alternative.

“ARTIBOO” – Qendra e Art Terapisë & Kreativitetit: organizim i aktiviteteve artistike dhe terapi kreative për fëmijët.

BESA Company: financim i shërbimeve të fizioterapisë për fëmijët.

“AUTOSHERRETI” - financim i shërbimeve psikologjike për fëmijët dhe të rinjtë.

KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME FERIZAJ: përmirësim i shërbimeve dhe mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara.

CARITAS KOSOVA: krijimi i mundësive për punë provuese për të rinjtë që sapo kanë përfunduar studimet, duke mbështetur integrimin e tyre profesional.

Këto marrëveshje kanë kontribuar në zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve, duke rritur mundësitë e zhvillimit, përfshirjes dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në komunitet.



KONFERENCA, TRAJNIME DHE GRUPE PUNUESE – 2025

Gjatë vitit 2025, stafi i Handikos Ferizaj ka marrë pjesë aktive në konferenca, punëtori, trajnime dhe grupe punuese, me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për fëmijët dhe familjet.

Në kuadër të bashkëpunimit me **UNICEF**, stafi ka ndjekur trajnime për **Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme**, përfshirë edhe Mbikëqyrjen Reflektuese, të cilat kanë kontribuar në forcimin e praktikave profesionale dhe zbatimin e një qasje gjithëpërfshirëse. Po ashtu, është ndjekur një trajnim tregëtor për trajnerë mbi Pjesëmarrjen dhe Përfshirjen e Fëmijëve, të organizuar nga **KOMF** dhe **Terre des Hommes – Kosovo**, ku pjesëtarë të stafit janë certifikuar si trajnerë përmes programit **MEGAFON**.

Handikos Ferizaj ka marrë pjesë gjithashtu në tryezën dyditore për **partneritetin publiko-privat në shërbimet sociale dhe familjare**, si dhe në takime koordinuese me Ekipet e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, Programin e Vizitave në Shtëpi dhe ekipet e Handikos nga disa komuna, përfshirë workshop-in e mbajtur më 25.11.2025.

Gjatë vitit, stafi ka ndjekur edhe trajnime për forcimin e partneritetit *Prind–Edukator–Terapist*, si dhe ka marrë pjesë në takime institucionale të thirrura nga Ministria e Drejtësisë, ku janë diskutuar mundësitë për rritjen dhe qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve sociale të ofruara nga sektori joqeveritar.

Këto aktivitete kanë ndihmuar në zhvillimin profesional të stafit, përf forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për fëmijët dhe familjet e përfituese.



MBËSHTETJE SOCIALE PËR FAMILJET DHE FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA



Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka realizuar aktivitete të rëndësishme të mbështetjes sociale për familjet dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Në kuadër të muajit të shenjtë të Ramazanit, janë mbështetur mbi 100 familje të fëmijëve me aftësi të kufizuara me pako ushqimore, ndërsa 50 familje janë furnizuar me 8 kg mish secila.

Ky aksion humanitar u realizua falë solidaritetit dhe bashkëpunimit me Bereqeti Dega – Ferizaj, Market Eli-Ab, si dhe disa donatorë anonimë. Përveç ndihmës ushqimore, janë dhuruar edhe rreth 450 palë këpucë për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të ofruara nga Shoqata Bereqeti.

Gjatë festave të fundvitit, Handikos Ferizaj ka shpërndarë gjithsej 850 dhurata për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara, duke synuar të sjellë gëzim, përfshirje dhe mbështetje emocionale për përfituesit dhe familjet e tyre.

Po ashtu, me iniciativën e z. Agon E. Zhinipotoku dhe z. Azem Çerkini, u organizua një iftar për 30 persona me aftësi të kufizuara, anëtarë të HANDIKOS Ferizaj. Ky aktivitet u mbështet nga z. Besnik Reka dhe Gjelltorja “Njëshi”, me pronar z. Minush Bakolli. Handikos Ferizaj shpreh mirënjohje të veçantë për të gjithë partnerët, donatorët dhe individët që kontribuuan në këto iniciativa humanitare, duke dëshmuar solidaritet, humanizëm dhe përkushtim ndaj përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara.

PUNA VULLNETARE

Historikisht, Handikos Ferizaj ka qenë i hapur dhe mikpritës ndaj punës vullnetare, duke inkurajuar përfshirjen e të gjithë individëve që shprehin dëshirë për të kontribuar në aktivitetet dhe iniciativat e organizatës. Kjo qasje ka vazhduar edhe gjatë vitit 2025, gjatë të cilit Handikos Ferizaj ka mirëpritur qindra vullnetarë, kryesisht nxënës të shkollave të mesme të larta dhe të mesme të ulëta, si dhe studentë, të cilët kanë kontribuar në aktivitete të ndryshme sociale, humanitare dhe komunitare.

Gjatë këtij viti, janë angazhuar vullnetarë nga SHFMU “Astrit Bytyqi”, SHFMU “Tefik Canga”, SHFMU “Ahmet Hoxha”, si dhe nga Shkolla Universum, të cilët kanë dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në mbështetjen e aktiviteteve të Handikos Ferizaj. Po ashtu, është realizuar bashkëpunim me vullnetarë nga Mural Fest, si dhe me z. Ezi Tahiri, i cili vullnetarisht është angazhuar në aktivitetet e festave të fundvitit duke u veshur si Babagjysh i Vitit të Ri, duke sjellë gëzim për fëmijët dhe përfituesit e shërbimeve.

Një iniciativë e veçantë vullnetare gjatë vitit 2025 ishte ngritja e fondeve për ndërtimin e qendrës së Handikos Ferizaj, e realizuar nga dy motrat Elma dhe Eliesa Çerkini, të cilat vullnetarisht ofruan qindra bizhuteri për shitje. Aktiviteti u zhvillua për dy ditë në sheshin e qytetit, dhe të gjitha të ardhurat nga shitja e bizhuterive u dedikuan për ndërtimin e qendrës së Handikos Ferizaj.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, me rastin e Festës së Fitër Bajramit, 45 fëmijë të qendrës së Handikos Ferizaj u gëzuan me dhurata simbolike, të dhuruara nga Malart Brahimaj, përfitues i rregullt i shërbimeve të qendrës, dhe tezja e tij, Blerina Kurti, duke promovuar solidaritetin, empatinë dhe frymën e vullnetarizmit ndërmjet bashkëmoshatarëve.



AKTIVITETE SOCIALIZUESE PËR FAMILJARËT

Gjatë vitit 2025, Handikos Ferizaj ka vënë një fokus të veçantë te prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke organizuar disa takime dhe aktivitete rekreative, kryesisht për nënat. Këto aktivitete përfshinin diskutime mbi tema të ndryshme të prindërimit dhe sfidave të përditshme, si dhe aktivitetet rekreative në Parkun e Lirisë.

Takimet dhe aktivitetet e realizuara kanë pasur një ndikim pozitiv të dukshëm, duke forcuar ndjenjën e përkrahjes dhe komunitetit ndërmjet prindërve, duke rritur mirëqenien emocionale të tyre dhe aftësinë për të përballuar sfidat e përditshme në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.





TalentBridge SH.P.K, me pronar z. Qëndrim Shkodra, 2,000 euro, për mbështetje në ndërtimin e Qendrës së re të Handikos Ferizaj.

Gjatë vitit 2025 ka vazhduar me intensitet dhe përkushtim mbledhja e fondeve për ndërtimin e qendrës së re të Handikos Ferizaj, një projekt strategjik dhe afatgjatë që synon krijimin e një hapësire moderne, funksionale dhe plotësisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Ky investim nuk përfaqëson vetëm një objekt fizik, por një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit, përfshirjes sociale dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron organizata jonë.

Gjatë këtij viti janë mbledhur gjithsej 81,000.00 € nga individë dhe kompani private, duke reflektuar solidaritetin dhe besimin e komunitetit në misionin tonë. Kontribut i veçantë është dhënë nga ProCredit Bank, e cila ka mbështetur projektin me një donacion prej 26,000.00 €, si dhe nga Fondi për Eficiencë të Energjisë, i cili ka investuar mbi 60,000.00 € për implementimin e masave të eficiencës së energjisë, duke e bërë objektin më ekonomik, më të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit.

Deri në fund të vitit 2025, objekti është përfunduar në rreth 80% të totalit të punimeve ndërtimore. Janë instaluar sistemi i ngrohjes dhe ftohjes me pompa termike, instalimet elektrike, sistemi i ujit dhe kanalizimit, duke krijuar bazën teknike për funksionalizimin e plotë të hapësirës. Fasadimin e jashtëm dhe i brendshëm është realizuar mbi 99%, çka e ka transformuar objektin në një strukturë moderne dhe të standardeve bashkëkohore.

Nyje sanitare janë të kontraktuara dhe pritet vetëm perioda e përshtatshme për instalimin e tyre përfundimtar. Punimet e mbetura përfshijnë instalimin e ashensorit, i cili është element kyç për qasje të plotë për personat me lëvizshmëri të kufizuar; shtrimin e dyshemeve me epoksid dhe mermer për qëndrueshmëri dhe mirëmbajtje më të lehtë; vendosjen e plafonit me sistem "Armstrong"; si dhe nisjen e procesit të inventarizimit dhe pajisjes me mobilie, pajisje rehabilituese dhe administrative.

Gjatë gjithë procesit është treguar kujdes që objekti të përmbushë standardet e qasjes universale, duke garantuar hapësira të përshtatshme për terapi, aktivitete ditore, këshillim, trajnime dhe mbështetje sociale. Qendra e re do të mundësojë zgjerimin e gamës së shërbimeve, rritjen e numrit të përfituesve dhe përmirësimin e kushteve të punës për stafin profesional.

Progresi i arritur gjatë vitit 2025 është dëshmi e angazhimit të vazhdueshëm institucional dhe komunitar. Me përfundimin e punimeve të mbetura dhe funksionalizimin e plotë të objektit, Handikos Ferizaj do të hyjë në një fazë të re zhvillimi, duke forcuar rolin e saj si një qendër referuese për mbështetjen dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

MBËSHTETJA FINANCIARE GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, shërbimet për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara janë realizuar falë mbështetjes së vazhdueshme financiare nga institucione publike, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, UNICEF dhe Komunën e Ferizajt, si dhe nga donatorë lokalë. Projektet dhe mbështetjet e ofruara kanë kontribuar ndjeshëm në ofrimin dhe vazhdimësinë e shërbimeve.

Përveç mbështetjes institucionale, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe donatorët lokalë, të cilët kanë kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe mbështetjen e përfituesve.

Kjo mbështetje e kombinuar institucionale dhe lokale ka qenë thelbësore për sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve, rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

